



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 23.4.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË AGJENCISË KOSOVARE
TË PRIVATIZIMIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikën e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Vlora Mehmeti, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit Bahri Statovci dhe anëtarë të ekipit Liridona Berisha nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Enver Boqolli.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	21
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	22
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	25
Shtojca IV: Komentet e OB-së për të gjeturat e raportit të auditimit.....	28
Shtojca V: Letër e Konfirmimit.....	33

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tutje AKP) për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 20.10.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërdrejt cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i AKP-se.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i Kualifikuar


Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale.

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Kryesuesin e Bordit të Drejtorëve dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

AKP ka marrë në konsideratë të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit. Komentet e AKP-së për çështjet për të cilat nuk jemi pajtuar janë dhënë në detaje në Shtojcën IV.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Drejtori menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe Zyrtarit Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kualifikuar

Kemi audituar PFV-të e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për bazën për opinion të kualifikuar PFV për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion të kualifikuar

Ne kemi krijuar bazën për opinionin të kualifikuar, për arsye se AKP në tabelën e dytë të pasqyrave financiare vjetore "Raporti i ekzekutimit të Buxhetit" tek hyrja e parasë së gatshme në llogarinë e thesarit, shuma e realizimit për të Hyrat e dedikuara ishte e pasaktë, respektivisht ishte vendosur shuma e ndarjeve të buxhetit final duke e mbivlerësuar këtë zë për 887,797€.

Për këtë arsye ne kemi kualifikuar opinionin tonë.

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZKA është e

pavarur nga AKP dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion të kualifikuar.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Drejtori menaxhues i AKP-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Bordit të Drejtoreshave është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të AKP-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

AKP kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013MF - për shpenzimin e parasë publike;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013MF - për raportimin e obligimeve të papaguara të organizuarave buxhetore;
- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF - nr.02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jo financiare në Organizatat Buxhetore;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve nga auditimi paraprak; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Marrë parasysh çka u tha me lartë, Deklarata e bërë nga Drejtori menaxhues i AKP-së dhe ud. Drejtori i Financave dhe Buxhetit, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Qeveri, përveç efekteve të çështjeve të cekura tek baza për opinion, mund të konsiderohet e saktë.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raporti

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet:

Rekomandimi 1 Prioritet i lartë - Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë duke përfshirë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga drejtori menaxhues dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për AKP-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet.

Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha Organizatat Buxhetore (OB) siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për të përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vet-vlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të pagave, prokurimit, pasurive dhe obligimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Menaxhmenti i AKP-së kishte zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar qeverisje të mirë në institucion. Megjithatë, auditimi ynë ka identifikuar një numër të dobësive të qeverisjes brenda AKP-së veçanërisht në lidhje me kontrollet menaxheriale, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Konfirmimet në listën kontrolluese të vet-vlerësimit të plotësuara nga AKP-ja nuk ishin të mbështetura me dëshmi, raportimi menaxherial jo i plotë dhe mos zbatimi i tërësishëm i rekomandimeve të vitit të kaluar nga auditimi i jashtëm janë çështje të cilat AKP-ja duhet t'i ketë parasysh për të përmirësuar qeverisjen në institucion.

Më tutje, AKP nuk kishte të miratuar planin strategjik. Mungesa e planit strategjik për realizimin e synimeve afariste dhe financiare, bën të pamundur që të përcjellët përmbushja e synimeve që duhej të realizoheshin në vitet vijuese. Këto fusha duhet të rishikohen si dhe të ndërmerren veprime konkrete për adresimin e tyre.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në AKP është funksionale dhe gjatë vitit 2016 kishte dhënë rekomandime të rëndësishme për përmirësimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm. Në këtë aspekt, menaxhmenti i AKP-së duhet të marrë në konsideratë përfitimin nga puna e Njesisë së Auditimit të Brendshëm për të ngritur nivelin e kontroleve në fushat me mangësi të theksuara.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 të AKP-së ka rezultuar me 16 rekomandime² kryesore. AKP kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Po ashtu, në takimet e Bordit të Drejtorëve ishte diskutuar për zbatimin e rekomandimeve, megjithatë menaxhmenti, nuk është mbështetur me një proces konfirmues ku zbatimi i rekomandimeve monitorohet formalisht.

Çështja 2 - Zbatimi i ulët i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet lartë

- Rreziku** Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, vetëm 4 (katër) rekomandime ishin zbatuar, 6 (gjashtë) janë zbatuar pjesërisht dhe 6 (gjashtë) nuk janë zbatuar ende. Kjo ka ndodhur për shkak se AKP nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.
- Rreziku** Mos zbatimi i rekomandimeve nga vitet paraprake në nivel të duhur pengon zhvillimin e proceseve për arritjen e objektivave në mënyrë efektive.
- Rekomandimi 2** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për zbatimin e planit të veprimit sipas afateve të përcaktuara, duke u fokusuar fillimisht në çështjet me të rëndësishme.

2.2 Pyetësori i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për AKP, më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit të ZKA-së. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe

² Në raportin e auditimit të vitit 2015 ZKA kishte dhënë 24 rekomandime duke përfshirë PFV-të e Agjencisë dhe PFV-të e Fondeve në Mirëbesim, por këtë vit këto dy palë PFV do të auditohen dhe raportohen ndaras. Ne vlerësuam se 16 rekomandime i takojnë auditimit të PFV-ve të Agjencisë, ndërsa 8 rekomandime i takojnë PFV-ve të Fondeve në Mirëbesim.

për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 3 – Pyetësi i vet-vlerësimit – Prioritet i mesëm

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentë. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

- strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit të institucionit nuk është hartuar. Sipas sqarimit të dhënë nga AKP, dokumenti strategjik është në proces të përpilimit nga agjencia; dhe
- proceset e monitorimit të rregullt lidhur me progresin e arritjes së objektivave konsiderohen si të vendosura, mirëpo dëshmitë për mbështetjen e konkluzioneve në lidhje me to janë të mangëta.

Rreziku Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 3 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se është rishikuar plotësisht i listës kontrolluese të vet-vlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Gjithashtu, duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit AKP operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Plani strategjik duhet të përfshijë qëllimet objektivat strategjike të organizatës, për të përcaktuar se ku është tani organizata dhe ku planifikohet të arrihet në një periudhë të caktuar.

Çështja 4 – Mungesa e planit strategjik – Prioriteti i lartë

- E gjetura** AKP nuk kishte hartuar planin strategjik i cili do të ofronte mbështetje për procesin e planifikimit operativ që do të lehtësonte monitorimin e procesit drejtë arritjes së rezultatit të synuar. Megjithatë gjatë kohës sa ishim në auditim (shkurt 2017) ishte përgatitur një strategji përmbyllëse për periudhën 2017 - 2023.
- Rreziku** Mos hartimi i planit strategjik si një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm ndikon në efektivitetin e planit operativ dhe financiar të AKP-së. Ky plan do të shërbente si bazë për të siguruar që politikat e Agjencisë zbatohen dhe përkrahin zbatimin e strategjisë.
- Rekomandimi 4** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprime për përcjelljen e objektivave strategjike dhe zbatimin e planit strategjik.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti kishte zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 5 – Mangësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Departamenti i financave përgatit raporte në baza mujore për menaxhmentin e lartë të AKP-së për aktivitetet dhe gjendjen financiare të agjencisë. Në raportet mujore të dorëzuara gjatë vitit 2016, departamenti i financave nuk kishte raportuar për gjendjen e llogarive të pagueshme, megjithatë në PFV kishte prezantuar gjendja e llogarive të pagueshme.
- Rreziku** Mos raportimi i duhur periodik për llogaritë e pagueshme tek menaxhmeti i lartë, rritë rrezikun e mos pagesës së obligimeve të papaguara në afatet e përcaktuara dhe planifikimin jo adekuat të rrjedhës së parasë së gatshme.
- Rekomandimi 5** Kryetari i Bordit duhet të sigurojë marrjen e veprimeve të nevojshme për raportim të plotë dhe të saktë të llogarive të pagueshme dhe pagesën e tyre brenda afateve të caktuara kohore.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me drejtorin, dy auditor dhe një zyrtar administrativ. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të AKP-së dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet i Auditimit efektiv. NJAB kishte hartuar planin e punës duke u bazuar në strategjinë për periudhën kohore 2014-2016. Për vitin 2016, NJAB kishte planifikuar gjithsejtë 8 (tetë) auditime, tri (3) prej të cilave mbulonin aktivitetet e menaxhimit të Agjencisë si Organizatë Buxhetore, ndërsa pesë (5) të tjera mbulonin aktivitetet e menaxhimit të Fondeve në Mirëbesim. NJAB kishte finalizuar të tri raportet e auditimit për Agjencinë në të cilat kishte dhënë rekomandime të rëndësishme për përmirësimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm. Menaxhmenti i AKP-së ka përgatitur planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe progresi i zbatimit të tyre është diskutuar në takimet e menaxhmentit.

Në vitin 2016 ishte themeluar dhe funksionalizuar komiteti i auditimit, i cili kishte mbajtur katër (4) takime dhe kishte shqyrtuar raportet e finalizuara nga NJAB dhe raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Sa i përket menaxhimit financiar dhe kontrollit AKP kishte dizajnuar një sistem të raportimit nga drejtorët e departamenteve tek menaxhmeti. Megjithatë, një numër i proceseve qeverisëse duhet të përmirësohen, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të Agjencisë.

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të siguruar menaxhimin e kontratave në pajtim me kërkesat ligjore. Po ashtu, kontrollet në menaxhimin e dosjeve të personelit, planifikimin e prokurimit për mallra dhe shërbime, menaxhimin e pasurisë dhe detyrimeve kanë nevojë për përmirësim të mëtutjeshëm.

Këto dhe dobësitë e tjera të prezantuara në këtë raport duhet të merren në konsideratë nga kryesuesi i Bordit të Drejtorëve për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin në AKP.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore dhe realizimi ndaj buxhetit në €

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ³	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	8,965,168	7,209,244	6,312,889	5,970,267	5,874,393
Granti i Qeverisë - Buxheti	1,816,039	9,515	9,515	10,572	406,183
Të hyrat e dedikuara ⁴	7,149,129	7,199,729	6,303,374	5,959,695	5,468,210

³ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

⁴ Të hyrat e dedikuara - janë të hyrat të cilat AKP i ka realizuar në bazë të nenit 64 të LMFPD dhe në bazë të nenit 21 të ligjit të AKP.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,755,924€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i kursimeve nga projekti për “Ri-organizimin dhe administrimin e NSH-së Trepça” në bazë të vendimeve të Qeverisë.

Në vitin 2016, AKP ka realizuar 88% të buxhet final ose 6,312,889€, që është shpenzuar në % të njëjtë me vitin 2015. Në tabelën nr. 3 kemi paraqitur ndarjet buxhetore dhe shpenzimet sipas kategorive ekonomike.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike në €

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	8,965,168	7,209,244	6,312,889	5,970,268	5,874,393
Pagat dhe Mëditjet	4,402,884	4,453,484	4,402,591	4,321,066	3,885,722
Mallrat dhe Shërbimet	3,944,284	2,537,760	1,745,292	1,401,519	1,754,835
Shërbimet komunale	98,000	98,000	73,594	84,980	77,636
Subvencionet dhe Transferet	490,000	90,000	78,809	116,003	63,300
Investimet Kapitale	30,000	30,000	12,603	46,700	92,900

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar për paga dhe mëditje ishte rritur në shumë për 50,600€ me vendim të qeverisë nr. 07/112 të datës 18.10.2016. Kjo rritje ishte bërë për arsye se AKP-së nuk ju kishte aprovuar buxhet i mjaftueshëm për këtë kategori me Ligjin e ndarjeve buxhetore për vitin 2016;
- Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar për mallra dhe shërbime ishte reduktuar në shumë 1,406,524€ nga programi buxhetor riorganizimi dhe administrimi i NSH-se Trepça. Qeveria e Kosovës për këto reduktime kishte nxjerr dy vendime gjatë vitit 2016, vendimin nr. 11/120 të datës 14.12.2016 për 795,639€ dhe vendimin nr. 01/123 të datës 28.12.2016 për 610,885€;
- Buxheti për subvencione dhe transfere ishte zvogëluar për 490,000€ në 90,000€ me vendimin e qeverisë Nr. 01/123 të datës 28.12.2016, të cilat ishin të ndara për riorganizimin dhe administrimin e Trepçës; dhe
- Buxheti për investime kapitale ishte 30,000€ ndërsa realizimi i ishte vetëm 12,603€. Kjo për shkak së projekti për riparimin e hapësirave të AKP-së nuk ishte realizuar për arsye se agjencia në të ardhmen mendon se nuk do të qëndrojë në objektet ekzistuese.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për Pagat dhe Mëditjet në vitin 2016 ishte 4,453,484€. Prej tyre ishin shpenzuar 4,402,591€. Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të qeverisë. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave në pajtim me kontratat e punës dhe legjislacionin e aplikueshëm.

Numri i pozitave të aprovuar për të punësuarit në AKP ishte 258, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit 2016 ishte 250 punonjës. Ne kemi testuar procedurat e rekrutimit, listat e pagave përfshirë edhe dosjet e personelit dhe prezantimin e tyre në PFV-të.

Çështja 6 - Të dhënat e personelit nuk ishin të kompletuara - Prioritet i mesëm

E gjetura Nga auditimi i dosjeve të personelit, ne kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Në 3 (tri) raste kualifikimet profesionale nuk ishin relevante me pozitat përkatëse;
- Në 3 (tri) raste mungonin kopjet e diplomave ndërsa në 2 (dy) raste ishin vetëm certifikatat për përfundimin e studimeve;
- Në 2 (dy) raste diplomat e fituara jashtë Kosovës nuk ishin të nostrifikuara sipas udhëzimit administrativ të MASHT Nr. 16/2016⁵;
- Në 2 (dy) raste në pozitat zyrtare ishin caktuar ushtrues detyre që nga viti 2014 dhe 2015, të cilët ende vazhdojnë të jenë ushtrues detyre. Sipas Ligjit për shërbimin civil (neni 30.4), ushtrues detyre nuk mund të emërohen më gjatë se tre muaj;
- Në 22 raste, emërtimet e pozitave në akt emërimi nuk ishin të listuara në rregulloren e pagave të nëpunësve të AKP-së, kjo ka krijuar mos pajtueshmëri me përshkrimin e emërtimeve të pozitave; dhe
- Raporti përmbledhës vjetor për vlerësimin e performancës nuk ishte dorëzuar brenda afatit kohor tek Ministria e Administratës Publike (MAP). Sipas rregullore nr. 19/2012⁶ ky raport duhet të dorëzohet në MAP deri më 15 janar të vitit pasues ndërsa ishte dorëzuar më 15 shkurt.

⁵ Sipas udhëzimit administrativ (MASHT) nr. 16/2016 parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave, neni 3 parimet e përgjithshme për njohje të barasvlere, të gjitha diplomat e shkollave të larta profesionale si dhe ato universitare të fituara jashtë vendit me qëllim punësimi, do t'u nënshtrohen procedurave të njohjes /barasvlerës

⁶ Rregullore nr. 19/2012 për vlerësimin e rezultateve në pune të nëpunësve civil.

Rreziku Mos zbatimi i kritereve në pajtueshmëri me legjislacionin e aplikueshëm rrezikon mos përmbushjen e objektivave të përgjithshme të AKP-së në nivelin e duhur.

Rekomandimi 6 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se është ndërmarrë një rishikim sistematik i dosjeve të personelit, për të siguruar përmbushjen e kërkesave në pajtueshmëri me legjislacionin e aplikueshëm, brenda një periudhe të caktuar kohore.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 2,635,760€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,818,886€. Ato kanë të bëjnë me udhëtimet zyrtare, riparim dhe mirëmbajtje, shërbime konsulente, shpenzime administrative, shpenzimet e sigurimit fizik të hapësirave të AKP-ës, reprezentacion, furnizim për zyre, qira, komunal, shpenzim të telefonit dhe shpenzim tjera.

Çështja 7 - Mangësi sistematike në Prokurim - Prioritet i lartë

E gjetura Gjatë testimeve në procedura të prokurimit kemi identifikuar mangësitë si më poshtë:

- Përgatitja e mirë e planit të prokurimit do të eliminonte nevojën për prokurime emergjente dhe ndarjen e kërkesave. Në 1 (një) rast ishte zhvilluar procedurë emergjente e cila ka mundur të planifikohej dhe në 3 (tri) raste për blerje të TI-së ishin ndarë kërkesat e prokurimit e që ishin të njëjta dhe të ndërlidhura.
- Në 3 (tri) raste menaxheri i kontratës nuk kishte përgatitur planin për menaxhimin e kontratës siç kërkohet me rregullat dhe udhëzuesin operativ të prokurimit publik; dhe
- Në 1 (një) rast anëtari i komisionit të vlerësimit ishte emëruar edhe menaxher i kontratës së njëjtë. Sipas rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurim publik asnjë anëtarë i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si menaxher i projektit.

Rreziku Planifikimi dhe menaxhimi jo i mirë i proceseve të prokurimit krijon hapësirë për rritjen e shpenzimeve dhe mos implementimin e kontratave, sipas kritereve në aspektin sasior apo cilësor dhe përmbushjen e tyre sipas afateve kohore.

Rekomandimi 7 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj marrjen e veprimeve të nevojshme për planifikimin dhe realizimin më të mirë të procedurave të prokurimit në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

Çështja 8 – Pagesat për shërbimet e pranuar në 2013 - Prioritet i lartë

- E gjetura** Çmimi i përmendur në kontratë duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të shërbimeve sipas kontratës.
- Sipas memorandumit për veprim të datës 01.09.2016 menaxhmenti i AKP-së kishte aprovuar pagesat e faturave për rastet e tejkalimit të kontratave për vitin 2013 në shumë 34,725€ për shërbimet e përkthimit, shërbimet postare, dizajnim i reklamës dhe gazetave vendore dhe ndërkombëtare. Kjo për shkak të keqmenaxhimit të kontratave nga personat përgjegjës për menaxhimin e kontratave të vitit 2013. Sipas AKP-së, këto pagesa ishin bërë më qëllim të shmangies së ndëshkimeve dhe interesave për pagesa të vonuara.
- Rreziku** Menaxhimi jo i duhur i kontratave nga personat përgjegjës rritë rrezikun e pagesave të parregullta dhe krijon pengesa në realizimin e objektivave të synuara.
- Rekomandimi 8** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për menaxhimin e duhur të kontratave nga personat përgjegjës dhe eliminimin e pagesave të parregullta.

3.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere në vitin 2016 ishte 90,000€. Prej tyre ishin shpenzuar 78,809€. Ato kanë të bëjnë me funksionin e menaxhimit të NSH-ve që janë nën administrimin direkt të AKP-ës me qëllim të ruajtjes dhe rritjes së vlerës të ndërmarrjeve para privatizimit.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2016 ishte 30,000€. Prej tyre ishin shpenzuar 12,603€. Ato kanë të bëjnë me pajisje të teknologjisë informative dhe riparimin e ndërtesës së AKP dhe të zyrave rajonale.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas PFV-ve vlera neto e pasurive kapitale me 31 dhjetor 2016 ishte 275,875€, ndërsa vlera neto e pasurive jo kapitale ishte 90,121€.

Çështja 9 – Mangësi në menaxhimin e pasurisë - Prioritet i mesëm

E gjetura Vlerat e pasurive jo financiare të prezantuara në PVF kërkohet të harmonizohet me regjistrin e E-pasurisë. Ne kemi identifikuar se vlerat e pasurive jo financiare të prezantuar në PFV-të nuk ishte harmonizuar me regjistrin e E-pasurisë. Pasuritë jo financiare nën 1000€ në PFV ishin prezantuar në vlerë 90,121€ ndërsa në regjistrin e E-pasurisë ishin në vlerë 53,448€ dhe kishin rezultuar me diferencë në vlerë 36,673€. Kjo diferencë ka ndodhur për shkak të problemeve me sistemin e e-pasurive (shkaku i zhvlerësimit).

Rreziku Mos harmonizimi i vlerës së pasurive të prezantuara në PFV dhe atyre në regjistrin e E-pasurive ndikon në prezantim jo të drejtë gjendjes së pasurive.

Rekomandimi 9 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë ndërmarr veprimet e nevojshme për regjistrimin e drejtë dhe të saktë të të gjitha pasurive dhe prezantimin në PFV.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 15,678€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017.

Nga organizatat buxhetore kërkohet të raportojnë të gjitha obligimet mujore të mbetura si të papaguara brenda afatit të kërkuar ligjor. Kjo bëhet me qëllim të ofrimit të informacionit të nevojshëm për palët e interesit.

Çështja 10 - Pagesa dhe raportimi i faturat nuk ishin në pajtueshmëri me rregullat financiare - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas rregullës financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, të gjitha faturat që i pranon organizata duhet të raportohen si obligime dhe të paguhen brenda 30 ditëve.

Në pesë (5) raste kishte vonesa në pagesën e faturave prej një (1) deri në gjashtë (6) muaj. Me tutje edhe fatura e muajit dhjetor për shpenzimet e rrymës, në shumë prej 5,594€ nuk ishte prezantuar në PFV si obligim i papaguar, që barten për tu paguar në vitin vijues.

Rreziku Mos pagesa dhe raportimi i faturave me kohë krijon papajtueshmëri me rregullat financiare dhe krijon efekte tjera zinxhirore që lidhen me daljen e parasë.

Rekomandimi 10 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë marrjen e veprimeve të nevojshme për të bërë pagesat e të gjitha faturave brenda afateve të caktuara kohore dhe prezantimin e të gjitha obligimeve në PVF.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera raportim	Kryesuesi i Bordit të siguroj që janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF-ve 2016 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçante në fushat me rrezik të në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF duhet të dorëzohet nëse ndaj draft PVF janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.			Nuk është zbatuar
2. 3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryesuesi i Bordit të sigurojë zbatimin e plotë me kohë planin e rishikuar për adresimin e rekomandimeve. Kjo duhet të monitorohet në baza të rregullta kohore dhe arsyet për mos adresimin e rekomandimeve nga vitet paraprake duhet të përcaktohen zyrtaret relavant dhe t'i raportohen menaxhmentit.	Është zbatuar		
2.4 lista kontrolluese e vetëvlerësimit	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Në proces të zbatimit. AKP kishte përgatitur regjistrin për adresimin e fushave që paraqesin rrezik.	

2.5.1 Hartimi i objektivave strategjike	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për vendosjen e objektivave strategjike dhe hartimin e planit strategjik.		Në proces të zbatimit. AKP kishte filluar për ta përgatitur një strategji përmbyllëse.	
2.5.3 Raportimi menaxherial	Kryesuesi i Bordit të shqyrtojë shkaqet e mos aplikimit të kontrolleve në mënyrë efektive dhe të sigurojë eliminimin e tyre në mënyrë që të përmirësojë dobësitë në procesin e shpenzimeve.			Nuk është zbatuar
2.5.3 Raportimi menaxherial	Kryesuesi i Bordit të sigurojë rekrutimin e stafit me kohe për të minimizuar periudhën e ushtruesit të detyrës			Nuk është zbatuar
2.6 sistemi i auditimit të brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, KA duhet të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm (për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe ti ofroj sigurinë e menaxhmentit). Gjithashtu duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm		Në proces të zbatimit. Komiteti i auditimit kishte shqyrtuar planin dhe raportet e auditimit të brendshëm.	
4.3 Planifikimi i buxhetit	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se janë analizuar arsyet për mosrealizimin e buxhetit dhe të përcaktojë veprimet praktike për të përmirësuar mangësitë. Për më tepër, të ketë një ndikim më të madhë në të gjithë pjesëmarrësit në planifikim të buxhetit, për të krijuar buxhetin më real financiar dhe në përputhje me objektivat e organizatës.		Në proces të zbatimit. Ishin analizuar çështjet që kanë ndikim në planifikimin e buxhetit për objektivat e organizatës.	
4.4 Prokurimi	Kryesuesi i Bordit të sigurojë ndjekjen e procedurave në mënyrë kronologjike ashtu siç përcaktohet me kornizën rregulluese.			Nuk është zbatuar
4.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditje)	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që zbatimi i procedurave të bëhet konform ligjit dhe rregulloreve në fuqi për shërbyesit civil		Në proces të zbatimit. AKP kishte bërë vlerësimin e performancës për të gjithë punonjësit.	

4.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditje)	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që zbatimi i procedurave me rastin e avancimit dhe gradimit të nëpunësve të behet konform rregullores mbi avancimin dhe gradimin e punonjësve.	Nuk kishte avancime/ gradime gjatë vitit 2016		
4.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditje)	Kryesuesi i Bordit të sigurojë kryerjen e vlerësimeve të performancës për të gjithë punonjësit.	Është zbatuar		
4.6 Pasuritë dhe detyrimet	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që pasuritë regjistrohen në grupimet e pasurive sipas kritereve për regjistrimin e tyre.		Në proces të zbatimit. Kanë filluar ti klasifikojnë pasuritë sipas kritereve për regjistrim.	
4.6.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryesuesi i Bordit duhet të forcojë nivelin e kontrolleve mbi menaxhimin e shpenzimeve të telefonisë mobile dhe të krijojë një sistem për arkëtimin e obligimeve të krijuara si rezultat i tejkalimeve të limiteve të përcaktuara.			Nuk është zbatuar
4.6.3 Trajtimi i borxheve	Kryesuesi i Bordit duhet të inicioj një analizë për furnizimet /shërbimet e marra pa u mbuluar me kontratë dhe të sigurojë që ZKF e ka shtuar fokusin duke ofruar një sistem të besueshëm të kontrollit për shërbimet apo furnizimet e porositura.			Nuk ishte zbatuar
4.6.3 Trajtimi i borxheve	Kryesuesi i Bordit të sigurojë që faturat evidentohen dhe protokolohen në librin e faturave dhe pastaj të bëhet shpërndarja për zyrtarët përkatës. Kjo praktikë mundëson që raportimi i obligimeve të jetë i saktë dhe i plotë dhe jep informata të plota për menaxhimin dhe palët tjera për obligime aktuale.	Është zbatuar		

Shtojca IV: Komentet e OB-së për të gjeturat e raportit të auditimit

Të gjeturat/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e AKP-së në rast të mospajtit	Pikëpamja e ZKA-së
<p>Çështja 1: Baza për opinion</p> <p>Në tabelën e dytë të pasqyrave financiare vjetore “Raporti i ekzekutimit të Buxhetit” tek hyrja e parasë së gatshme në llogarinë e thesarit, shuma e realizimit për të Hyrat e dedikuara ishte e pasaktë, respektivisht ishte vendosur shuma e ndarjeve të buxhetit final duke e mbivlerësuar këtë zë për 887,797€.</p>	JO	<p>Agjencia Kosovare e Privatizimit financohet nga të Hyrat e Dedikuara dhe është rast unik, sa i përket trajtimit të të hyrave të dedikuara në krahasim me institucionet tjera që gjenerojnë të Hyra Vetanake.</p> <p>Pra, Agjencia edhe në përputhje me Ligjin e Buxhetit nuk planifikon të hyra, por vetëm planifikon shpenzimet për të cilat i ka paraqitur në Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit, si e hyrë totalin e buxhetit të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.</p> <p>Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit nuk ndërlidhet saktësisht me specifikat e AKP-së, por standardi kërkon që të bëhet përshtatshmëria, të cilën e kemi praktikuar nga viti 2012 me raportet nëntëmujore dhe vjetore.</p> <p>Departamenti i Thesarit (Ministria e Financave) ka pranuar se formati i tanishëm i raportimit të ekzekutimit të buxhetit, nuk përshtatet me specifikat që ka Agjencia, mirëpo, ky raport në të ardhmen duhet modifikuar.</p> <p>Sqarimet e dhëna më parë nga Thesari për ZKA-në nuk kanë qenë në përputhje me Ligjin e AKP-së dhe nuk ka marrë parasysh specifikat që ka Agjencia. Nuk ka arritur të bëjë dallimin në mes të Hyrave të Dedikuara dhe të Hyrave Vetanake.</p>	<p>Sipas Rregullores MF nr. 1/2017 për raportim financiar të OB-ve dhe sqarimeve të dhëna nga Thesari, në tabelën e dytë të pasqyrave financiare vjetore “Raporti i ekzekutimit të Buxhetit” tek hyrja e parasë së gatshme vendoset realizimi / grumbullimi në llogarinë e vetme të thesarit gjatë vitit fiskal raportues (Nga 1 janari deri me 31 dhjetor) e jo ato të buxhetuara. Andaj e gjetura dhe rekomandimi qëndron.</p>

	<p>Prandaj, në takimin e mbajtur mes Departamentit të Thesarit, ZKA-së dhe AKP-së më 14 Qershor 2017, Thesari është zotuar se do të përcjell në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA) një sqarim për tabelën 2 të Pasqyrave Financiare të AKP-së për arsye të specifikave dhe për arsye se nuk bën planifikim të të hyrave, por vetëm planifikim të buxhetit nuk do të paraqet buxhetin fillestar por as buxhetin final ne raportin e e ekzekutimit te buxhetit.</p> <p>AKP-ja ka bërë shpalosjen për të hyrat e dedikuara në shënimin 11 dhe në shënimin 19 (raport për të hyrat e dedikuara).</p> <p>Pasqyrat Financiare Nëntëmujore dhe Vjetore të AKP-së janë audituar nga Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë këtyre viteve, dhe për të cilat ekipet e auditimit kanë kuptuar në mënyrë të drejtë përshtatshmërinë dhe trajtimin e të hyrave të dedikuara për specifikat e AKP-së që është paraqitur vetëm buxheti i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.</p> <p>Ekipit të Auditimit, i janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për rrjedhën e procesit të transferimit të mjeteve për buxhetin e vitit 2016 të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës për AKP-në.</p> <p>AKP-ja me 15 Janar 2016, pas harmonizimit të shpenzimeve me Thesarin, ka bartur në llogari mjetet shtesë prej 6.3 milion në llogarinë e “AKP Privatizimi Tarifa Administrative” duke llogaritur edhe bilancin fillestar të gjendjes bankare, që sipas ligjit të AKP-së dhe Ligjit të Buxhetit, tepricat barten për vitin pasues.</p>	
--	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--

		Marrë parasysh gjendjen e shpalosur dhe faktet e prezantuar, AKP-ja nuk pajtohet me të gjeturën që ka konstatuar Ekipi i Auditimit nga ZKA-ja. .	
Çështja 2: Zbatimi i ulët i rekomandimeve nga viti paraprak	JO	AKP-ja në vazhdimësi ka bërë adresimin e të gjitha rekomandimeve të dhëna nga ZKA-ja. Për më tepër, Agjencia ka hartuar planin e adresimit të rekomandimeve jo vetëm për vitin 2015, por edhe për rekomandimet e viteve 2014 dhe 2013. I njëjti plan i adresimit të rekomandimeve të ZKA-së është diskutuar edhe në takimet e Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit të Auditimit. Ky plan i adresimit të rekomandimeve azhurnohet në baza tremujore.	Ne kemi konstatuar se nga 16 rekomandime të dhëna në vitin paraprak, ishin zbatuar 4 rekomandime, 6 rekomandime pjesërisht, ndërsa 6 rekomandime nuk ishin zbatuar ende. Andaj e gjetura dhe rekomandimi qëndron.
Çështja 3: Pyetësi i vet-vlerësimit E gjetura- Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponentë. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se: - Strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit të institucionit nuk është hartuar. Sipas sqarimit të dhënë nga AKP, dokumenti strategjik është në proces të përpilimit nga agjencia; dhe - Proceset e monitorimit të rregullt lidhur me progresin e arritjes së objektivave konsiderohen si të vendosura, mirëpo dëshmitë për mbështetjen e konkluzioneve në lidhje me to janë të mangëta.	JO	AKP ka përgatitur dhe miratuar strategjinë gjithëpërfshirëse (2017- 2023) nëpërmjet të cilës do të realizohet misioni sipas mandatit të përcaktuar nga Kuvendi i Kosovës për AKP-në. Strategjia do të shërbej si dokument thelbësor për realizimin e objektivave për të cilat do të planifikohen dhe realizohen planet detaje të punës të AKP-së. Gjithashtu, nëpërmjet këtij dokumenti është parashikuar edhe periudha e realizimit të misionit sipas mandatit të përcaktuar për AKP-në.	AKP nuk kishte një strategji të miratuar gjatë vitit 2016 apo më herët. Strategjinë përmbyllëse për periudhën 2017 - 2023 AKP e ka përgatitur në shkurt 2017. Ne mirëpresim përgatitjen e strategjisë për vitet 2017-2023 megjithatë, objektivi i auditimit është viti 2016, andaj e gjetura dhe rekomandimi qëndron.

<p>Çështja 4: Mungesa e planit strategjike E gjetura-AKP nuk kishte hartuar planin strategjik i cili do të ofronte mbështetje për procesin e planifikimit operativ që do të lehtësonte monitorimin e procesit drejtë arritjes së rezultatit të synuar.</p>	JO	Referoju komentit tek çështja nr.3.	Referoju komentit më lartë (nr.3)
<p>Çështja 5: Mangësi në kontrollet menaxheriale E gjetura-Departamenti i financave përgatit raporte në baza mujore për menaxhmentin e lartë të AKP-së për aktivitetet dhe gjendjen financiare të agjencisë. Në raportet mujore të dorëzuara gjatë vitit 2016, departamenti i financave nuk ishte raportuar për gjendjen e llogarive të pagueshme, megjithatë në PFV ishte prezantuar gjendja e llogarive të pagueshme</p>	JO	<p>Nëpërmjet raporteve (shpesh edhe javore) mujore të cilat përcillen tek Menaxhmenti nga Departamentet përkatëse të AKP-së, Departamenti i Financave, si pjesë e aktivitetit të saj, raporton edhe për gjendjen e obligimeve të papaguara të cilat janë përcjellë në Thesar të Ministrisë së Financave dhe Buxhetit. Auditori është njoftuar për mënyrën e raportimit tek Menaxhmenti sa i përket çështjeve të obligimeve të papaguara.</p>	<p>Në raportet mujore që janë përcjellur tek menaxhmenti nga departamenti i financave nuk kishte dëshmi për gjendjen e obligimeve të papaguara si në vijim: Raportit mujor për muajin shtator i është bashkangjitur gjendja e obligimeve të papaguara për muajin korrik e jo për muajin shtator, po ashtu edhe raportit të muajit qershor i është bashkangjitur gjendja e obligimeve të papaguara për muajin maj e jo për muajin qershor. Andaj e gjetura dhe rekomandimi qëndron.</p>

<p>Çështja 8: Pagesat për shërbimet e pranuar në 2013</p> <p>E gjetura-Çmimi i përmendur në kontratë duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të shërbimeve sipas kontratës.</p> <p>Sipas memorandumit për veprim të datës 01.09.2016 menaxhmenti i AKP-së kishte aprovuar pagesat e faturave për rastet e tejkalimit të kontratave për vitin 2013 në shumë 34,725€ për shërbimet e përkthimit, shërbimet postare, dizajnim i reklamës dhe gazetave vendore dhe ndërkombëtare. Kjo për shkak të keqmenaxhimit të kontratave nga personat përgjegjës për menaxhimin e kontratave të vitit 2013.</p>	JO	<p>Ky problem është identifikuar vite më parë, nga Departamenti i Financave dhe Buxhetit. për të cilën ka bërë ndalesë dhe për të cilën ka pasqyruar të gjitha ngjarjet rreth këtyre rasteve. Gjithashtu janë pasqyruar në mënyrë të detajuar konkluzionet dhe arsyeshmëria (me vendim të Menaxhmentit) për procesim të këtyre pagesave. Pasi që për këto raste, pagesat më të mëdha do të kishte pala, në rast se do të shkonin me konteste gjyqësore dhe përveç pagesës së obligimeve do të paguanim edhe shpenzimet gjyqësore.</p>	<p>AKP jep vetëm sqarime duke mos e kundërshtuar të gjeturën. Andaj e gjetura dhe rekomandimi qëndron.</p>
---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Shtojca V: Letër e Konfirmimit

LETËR E KONFIRMIMIT


Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmojmë se:

- kemi pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohemi me të gjeturat dhe rekomandimet për të cilat nuk kemi dhënë komente, ndërsa për të gjeturat të cilat nuk pajtohemi, ju lutem referojuni komenteve tona (shih Shtojcën IV: Komentet e AKP-së për të gjeturat e draft-raportit të auditimit të AKP-së);
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzojmë një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.


z. Ekrem Hajdari
Drejtor Menaxhues

Data: 27.06.2017, Prishtinë,